



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.20/2025

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Mejreme Memaj e Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Bujar Leci, nga fshati G., komuna e K., për veprën penale vjedhje pylli, parashikuar me nenin 349 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë avokatit Selmon Sadiku, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.117/2022 datë 11 gusht 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25 shkurt 2025, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit Bujar Leci mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjilan -Dega në Kamenicë, P.nr.117/2022 datë 11 gusht 2023.

### A r s y e t i m i

I dënuari Bujar Leci me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, P.nr.117/2022 datë 11 gusht 2023, për veprën penale vjedhje pylli, parashikuar, me nenin 349 par.2 të KPRK-së, është gjykuar me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, ekzekutimi i të cilit është shtyrë për një (1) vit, me kusht që i dënuari pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit brenda këtij afati të mos kryej vepra penale dhe me dënim me gjobë në shumë prej dyqind e pesëdhjetë (250)€ të cilën është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit në tri këste mujore, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që në një ditë burgu do t'i llogariten 20€ të gjobës.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1242/2023 datë 29 janar 2025.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati Selmon Sadiku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.8/2025 datë 23 janar 2025, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 383 par.1 nenpar.1.12 të KPP, pasi që aktgjykimi është marrë në kundërshtim me nenin 370 të KPP, pra, dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, pra, i gjithë arsyetimi sillet rreth pretendimeve të dëmtuarit dhe pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një të dëmtuar që është i njohur për gjykatën dhe në dëshminë e tij duket qartë dëshira për përfitim pasuror, dhe gjykata nuk është dashtë ta shpall fajtor të mbrojturin e tij në një provë të vetme.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtësi në rastin konkret pretendon se është shkelur ligji penal për faktin se gjykata nuk e ka zbatuar nenin 3 par.2 të KPP dhe mos zbatimi i neni ka sjellë deri të një aktgjykim jo i drejtë. Gjykata faktet kontradiktore i ka marrë si fakte të vërtetuara në dëm të dënuarit. Në shqyrtimin gjyqësor është kërkuar që të dëgjohet I. K. në cilësi të dëshmitarit dhe pasi që ai nuk kishte ardhur ka propozuar që të sillet me dhunë, pasi që kishin informata se ai ishte kërcënuar nga I. B. duke i thënë që *“nëse nuk dëshmon kundër meje unë sa herë t'i gjejë bagëtinë në pronat e mija do të gjobiti dhe do ta nxijë jetën”*, pasi I. K. ka 70 krerë lopë dhe pronat e tij kufizohen me pronat e I. B.. Nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike pasi që nuk është ftuar të dëshmojë asnjë menaxher i fabrikës së ujit “K.”, ku ka qenë duke prerë drunjtë i mbrojturi i tij, kurse i dëmtuari nga inati pse nuk e kanë marrë atë me i pre drunjtë në vendin ku ndodhej fabrika në shenjë hakmarrje ka shpifur dhe ka arritur ta akuzoj Bujar Lecin. Përveç kësaj dëshmitari N. A.- teknik i pylltarisë në dëshminë e tij nuk ka dëshmuar asgjë konkrete dhe i njëjti ka deklaruar se lisat janë prerë para një apo dy viteve, kurse i dëmtuari pretendon se janë prerë para pesë apo shtatë muajve, kurse as dëshmitari F. M. nuk dëshmon asgjë, prandaj është dashur të vjen në shprehje parimi *“in dubio pre re”*. Me tej sipas mbrojtësit gjykata e shkallës së dytë as që ka analizuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ankesën e ushtruar ndaj tij.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e lartcekura nuk janë të bazuara për këto arsye:

Se pari, vlen te theksohet se pretendimet përkitazi me shkeljet esenciale të procedurës penale janë të paqarta, mbrojtësi i referohet dispozitës së nenit 383 par.1 nënpar.1.12 të KPP, por, kjo dispozitë me kodin e ri të procedurës penale ( të vitit 2023), e që ishte i aplikueshëm gjatë gjykimit në shkallë të parë i referohet shkeljes së ligjit penal, kurse, dispozita në të cilën thirret mbrojtësi ka të bëjë me nenin 384 par.2 nënpar.2.7 - aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me dispozitën e nenit 369 të KPP.

Së dyti, mbrojtësi përveç që gabimisht citon dispozitën ligjore nuk konkretizon se në çka konsistojnë këto shkelje, kurse arsyet e dhëna edhe pse të pakta i referohen gjendjes faktike sepse kontestohet dëshmia e të dëmtuarit si dëshmitar.

Se treti, pretendimet përkitazi me shkeljet e ligjit penal kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ( ngase kontestohen dëshmia e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve) për të cilën bazë ligjore kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të parashtrohet – neni 432 par. 2 i KPP.

Përkundër të lartcekurave kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat pretendohet në kërkesë. Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe në të janë përshkruar në mënyrë të qartë veprimet inkriminuese të të dënuarit, veprime këto që paraqesin tiparet e veprës penale, për të cilën ai është dënuar, kurse në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, konform dispozitës së nenit 369 par.7 të KPP, janë vlerësuar të gjitha pikat e aktgjykimit, pra, gjykatat kanë dhënë arsye për të gjitha provat e administruara dhe lidhur me to kanë paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta i ka pranuar edhe gjykata e shkallë së dytë dhe si të tilla i pranon edhe kjo o Gjykatë.

Është evidente se sipas parimit “in dubio pro reo”, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave tij, mirëpo, ky parim nuk gjen zbatim në rastin konkret sepse me asnjë provë të administruar në këtë çështje juridiko penale nuk vihet në dyshim përgjegjësia penale e të dënuarit, pra, kjo gjykatë mbështet konkludimin e gjykatave se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilës është shpall fajtor.

Për arsyet e cekuar më lartë kërkesa u refuzua si e pabazuar, kurse në kuptim dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**  
PML.nr.20/2020, me 25 shkurt 2025

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit  
Afrim Shala